



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 03  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S - I  
Prishtinë, më 01 nëntor 2017, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

**Mungoi:** Faton Topalli.

**Të ftuar:** Skender Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- MPMS.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Izedin Bytyçi, sekretar i MPMS-së, Mentor Tërshnjaku, këshilltar në MPMS, Bahri Xhaferi, MPMS, Minire Begaj, MPMS, përfaqësues KDI-së dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Shprese Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**REND I DITËS**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.10.2017;**
- 3. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica. Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës;

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.10.2017;

**Kryetari** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 18.10.2017.

## 3. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica. Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë;

**Kryetarja:** Komisioni ka vendosur që t'ju ftojë në takim njoftues. Pra, t'ju dëgjojmë fillimisht juve për sfidat dhe prioritetet që i keni ju, si ministri. Komisioni ynë përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike që janë në Kuvend. Ne, si Komision, jemi zotuar se do të bashkëpunojmë ngushtë me ju dhe do ta keni mbështetjen tonë nëse ju punoni angazhoheni të avanconi apo përmirësoni mirëqenien e qytetarëve, në të kundërtën nëse nuk punoni ashtu siç duhet, ne do të jemi kritikuesit e punës tuaj dhe qeverisë në rolin që kemi si komision. Duke e pasur parasysh se vendi ynë është vendi me i varfër edhe vendi me një papunësi të madhe në rajon., prej jush kërkohet një punë dhe angazhim i madh në përmirësimin e kësaj situatë. Ministër kërkohet nga ju që t' na paraqitni se cilat janë sfidat dhe prioritetet si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale?

**Skender Reçica:** Ju falënderoj për ftesën të cilës i jam përgjigjur me kënaqësi. Do të mundohem që para jush të prezantoj sfidat me të cilat përballemi ne, si ministri, gjithashtu edhe prioritet apo objektivat që i kam si ministër i ri. Edhe ne zotohemi se do t' ju ofrojmë një bashkëpunim të thellë edhe të vazhdueshëm me komisionin. Fillimisht po i paraqes sfidat mandej edhe prioritetet dhe objektivat tona. MPMS-ja në bazë të kompetencave të saj është përgjegjëse për hartimin e politikave, hartimin dhe zbatim të legjislacionit për çështje të punës, punësimit dhe mirëqenies sociale. Përcjellja e punësimit dhe prezantimin e masave adekuatë të nxitjes së punësimit dhe zvogëlimit të papunësisë. Vendosjen e standardeve për siguri dhe shëndet në punë. Përcjelljen e ecurisë së mirëqenies sociale dhe masave adekuatë për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Administrimin dhe përkrahjen e sistemit të sigurisë sociale përfshirë edhe sistemin pensional dhe beneficioneve të kategorisë së luftës.

Në kuadër të kompetencave, ne si MPMS ballafaqohemi me sfidat si në çështjen e punësimit pra buxhet të pamjaftueshëm për zbatimin e masave aktive të tregut të punës. Zvogëlimin e shkallës së aktivitetit dhe zvogëlimin e punësimit jo formal. Përfshirja e kufizuar e të papunëve në shërbime të punësimit dhe masat aktive të tregut të punës në fokus të veçantë të gratë dhe të rinjtë. Ngritja e kapaciteteve dhe infrastrukturës teknike të zyrave të punësimit. Përgatitja e pakos së re legjislative nga fusha e marrëdhënies së punës. Dialogut social, sigurisë dhe shëndetit në punë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe Marrëveshjen për Stabilizim Asociim – MSA. Përcaktimi i pagës minimale dhe arritja e konsensusit për pushimin e lehonisë. Rishikimi dhe dha zbatimi i kontratës kolektive. Fuqizimi dhe ngritja e numrit të inspektoreve të punës. Këto janë nder sfidat kryesore që ballafaqohemi te çështja e punësimit. Ndërsa sa i përket politikave sociale dhe shërbimet sociale, kemi këto sfida; kufizimet buxhetore që janë pengës për zbutjen e varfërisë dhe përfshirjen sociale përmes skemave sociale, decentralizimi jo i qartë i kompetencave nga niveli qendror tek ai lokal, mungesa e qëndrueshmërisë financiare për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, granti specifik për shërbimet sociale, përfshirja e kategorisë së dytë si përfitues të skemës sociale në programet e punësimit dhe aftësimin profesional, pastaj

ngritja e kapaciteteve të komunave, punëtorëve socialë për dhe OJQ-ve përmes procesit të licencimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare.

Sfidat të pensionet janë mosmbulimi i të gjitha kategorive në skemat aktuale të pensioneve dhe beneficioneve si rezultat i kufizimeve buxhetore. Fillimi i zbatimit të pensioneve familjare dhe invalide të punës. Fillimi i zbatimit të pensioneve për paraplegjikët dhe tetraplegjikët.

Sfidë kemi edhe në kategorizimin dhe përshkallëzimin e aftësisë së kufizuar me qëllim të përfshirjes në tregun e punës. Njohja e stazhit të punës për të përfituar pensionin kontributdhënës. Arritja e marrëveshjeve për sigurimet sociale dhe finalizimi i proceseve të negociimit për marrëveshjet që janë në proces Zvicra, Belgjika dhe inicimi i marrëveshjeve tjera. Mungesa e një sistemi informativ të integruar të të dhënave për eliminimin e përfituesve të dyfishtë brenda MPMS-së dhe fondeve tjera publike. Kurse sfidat tek kategoritë e luftës. Implementimi i plotë i Ligjit 04 L-054 për shkak të refuzimit të pranimit të aplikacioneve si rezultat i një vendimi të ish- ministrit z. Rashiq. Ky vendim është shfuqizuar dhe krijohet komisioni mjekësor për caktimin e shkallës së invaliditetit të ushtarëve të UÇK-së. Kategorizimi i veteranëve, fillimi i zbatimit të pagesave për viktimat e dhunës seksuale. Këto janë disa nga sfidat të cilat jemi duke u ballafaquar si MPMS, të cilat do t'i adresojmë në të ardhmen.

Objektivi kryesor i MPMS-së është që të punësojmë nga një anëtarë në secilën familje që s'kanë asnjë të punësuar. Do të krijojmë një sistem për ti identifikuar, i cili do të lidhet me bazën e të dhënave të integruar dhe sistemin e institucioneve tjera. Zvogëlimi i përfituesve të asistencës socialë përmes aktivizimit në tregun e punës, pra zvogëlimin e përfituesve nga kategoria e dytë. Në këtë aspekt, do të ketë edhe subvencionim të pagave në angazhim të punëve publike dhe dhënie të grandeve për vetëpunësim.

MPMS-ja do të angazhohet në ndryshimin e kurrikulave të qendrave të aftësimin profesional dhe përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës. Avancimi i kushteve të punës për punëtorët, luftimi i punësimit joformal. Garantimi i standardeve minimale për kushtet e punës dhe shëndetit në punë. Hartimi i ligjit të ri të punës, i cili do të përafrohet me direktivat e BE-së dhe në harmoni me kërkesat e punës, i cili do të mbrojë kërkesat e punëdhënësve dhe punëmarrësve. Fuqizimi i Inspektoratit të Punës, reformë ligjore tek ky sektor. Rritje numrit të inspektorëve rritjes së mbikëqyrjes së Inspektoratit. MPMS-ja do të përkushtohet në zhvillimin, nxitjen dhe promovimin e dialogut social. Funksionalizimin e trupave profesionale të Këshillit Ekonomiko Social. Fuqizimin e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare që do të realizohet përmes Ligjit për Ndërmarrjet Sociale, i cili ka për synim tri qëllime; qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve sociale, ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe punësimin e personave me nevojë sociale.

Regjistrimin e ndërmarrjeve sociale, të cilat do të ofrojnë këto shërbime dhe do t'ju ofrojnë punësim grupeve të cenuara. Sigurimin e grantit specifik për shërbimet sociale të decentralizuara në nivelin lokal. Reforme ligjore të sistemit pensional. Objektiv tjetër është edhe zbatimi i Ligjit për Kategoritë e Dala nga Lufta, në realizimin e të drejtave të tyre, pensionet dhe beneficinet. Pra këto janë disa nga objektivat tona për këtë mandat, të cilat sigurisht edhe me mbështetjen tuaj do të realizojmë...

**Besa Baftiu:** Urojmë që të keni edhe mbështetjen e Qeverisë në përmbushjen e këtyre objektiveve me qëllim që të kemi një përmirësim të mirëqenies së qytetarëve. Në programin qeverisës keni theksuar se do të bëni hartimin e Ligjit të ri të punës. A do të hartoni një ligj të ri apo vetëm ndryshimin dhe plotësime të tij?

Të marrëveshjet bilaterale. Siç e dimë kemi ndërprerje të marrëveshjeve siç është rasti me pensionet për qytetarët tanë që kanë punuar në Zvicër. Marrëveshja është ndërprere në viti 2009

dhe në mandatin e kaluar ministri Abrashi ka punuar mjaftë, mirëpo, ende nuk kemi diçka definitive se deri ku ka shkuar në cilën fazë është apo do të rifilloni me negociata?

Ju potencuat se do të shtoni numrin e inspektoreve të punës, po ashtu, do të shtohet edhe mbikëqyrja e Inspektoratit të Punës. Ne e dimë se çfarë gjendje e kemi në sektorin privat fatkeqësisht në muajin e fundit i kemi dy raste apo fatkeqësi, ku dy punëtorë kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës. Kurse në vitin e kaluar kemi pasur 9 raste apo fatkeqësi. Rritja e numrit të inspektorëve dhe shtimi i mbikëqyrjes ndaj Inspektoratit të Punës do të kemi një zbatim me të mirë të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Siguri dhe Shëndetin në Punë. Ministër, fillimisht po i marrim pyetjet edhe vërejtjet e deputetëve, mandej përgjigjesh.

**Enver Hoti:** Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se në çfarë gjendje po kalon vendi ynë, qoftë në politikat e punësimit dhe gjendja e përgjithshme sociale. Kjo është sfida kryesore që do t'ju përcjellë pothuajse gjatë gjithë mandatit. Ato që i prezantuat ju si sfida janë reale kufizimet buxhetore, punësimi joformal gjendja e sigurisë në punë etj. Kurse objektivat që i prezantuat urojmë që ti përmbushni. Qasja që prezantuat që përfituesit e skemave sociale dhe e njerëzve me aftësi të kufizuara të integrohen në procesin punësimit. Vendimin të cilin e keni marrë për formimin e Komisionit Invalidor, ju përgëzojmë. Në këtë rast kërkojmë që ky komision të funksionalizohet sa më shpejtë pasi që kemi një vonesë të gjatë dhe invalidët janë në një gjendje jo të mirë. Po ashtu edhe kategorizimi i veteraneve të UÇK-së kërkon një dinamikë të shtuar pasi që edhe kjo çështje duhet të mbyllet sa më parë.

Decentralizimi i kompetencave apo bashkëpunimi në mes nivelit qendror dhe lokal të shërbimit sociale. Besojmë edhe kjo çështje duhet të qartësohet, kompetencat dhe përgjegjësit e dy niveleve, pasi që nuk kemi një funksionim të mirë, shpeshherë kemi edhe tejkalim të kompetencave.

Pjesë e programit Qeverisës, e kemi që çdo familje të këtë se paku nga një të punësuar, sfidë kjo e cila besoj se do të realizohet. Ne do të ju përkrahim shumë si komision. Bashkëpunimi apo mbështetja jonë s'do të mungojë për punë të mira në përmirësim të mirëqenies se gjithë qytetarëve të vendit tonë.

**Naser Rugova:** Ne dëgjuam me vëmendje ekspozenë tuaj. Është krijuar një praktike e mirë komunikimit ndërinstitucional në këtë rast komisionet e Kuvendit të cilat i monitorojnë dikasteret qeveritare në funksion të asaj që të kemi një transparence, llogaridhënie si dhe realizimin e agjendës legjislative dhe zbatimin e legjislacionit, i cili kohëve të fundit ka qenë sfidë e madhe në disa dikastere. Ne si komision pa marrë parasysh përkatësinë politike për një fushë të ndjeshme të kategorive shoqërore dhe sociale, vërtet do të japim kontributin tonë të çmueshëm. Unë do të ndalem dhe do ju inkurajoj të krijimi i politikave të punësimit të keni një vëmendje të shtuar. Të marrim modele të mira të vendeve që kanë pasur sukses, mirëpo, gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit t'i përshtatemi karakteristikave dhe gjendjes tonë, të cilën e kemi në vend. Jemi të vetëdijshëm që nuk keni buxhet të mjaftueshëm, kemi një shkallë të lartë të papunësisë edhe sfidat tjera në këtë rast, unë konsideroj se duhet një pako e re legjislative reformuese që do ti prekë të gjitha kategoritë.

Inspektorati i Punës është njëra nga hallkat jashtëzakonisht të rëndësishme në përmbushjen e objektivave tuaja. Kemi raste të shumta të lëndimeve dhe humbjes së jetës në vendin e punës. Përfshirja e shërbimeve sociale, mungesa e sistemit të integruar të përfituesve dhe të angazhuarve në punë është i rëndësishëm se veçantë, ashtu siç e potencuat do t'ju lehtësojë punë shumë që të kemi përfitues njerëz meritore. Sa i përket familjeve që s'kanë asnjë të punësuar, ju duhet mjaftë kohë që ti identifikoni dhe të keni të dhëna të sakta zyrtare. Njohja e stazhit të punës në veçanti për njerëzit të cilët kanë dhënë një kontribut të çmueshëm, në këtë rast na duhet si Kuvend dhe Qeveri, që këtyre njerëzve t'ju njihen meritat dhe munda që kanë dhënë për

vendin. Kemi një mos përputhshmëri në mes të shkollave profesionale, pra kurikulave me tregun e punës, të krijoni një komunikim të mirëfilltë me MASHT-in dhe të kemi kurrikula profesionale që janë në përputhshmëri me tregun e punës. Edhe programet që po akreditohen në arsimin e lartë duhet të analizohen sepse po prodhojmë kuantitet të kuadrove në drejtime dhe programe të caktuara, që nuk janë në harmoni me tregun e punës. Pra, ju si ministri e MPMS-së, MASHT-i dhe institucionet tjera të bëni një fizibilitet të tregut të punës për 20 vitet e ardhshme, siç e bëjnë edhe vendet tjera. Uroj që të kemi bashkëpunim dhe bashkërisht të marrim hapa konkret edhe të përmirësojmë mirëqenies e qytetarëve tanë.

**Fatmire Kollçaku-Mulhaxha:** Ministër, ju para nesh prezantuat një plan mjaft ambicioz. Sa nga kërkesat tuaja janë refuzuar që të përkrahën me buxhet për vitin 2018, në mënyrë që gjatë shqyrtimit të buxhetit për vitin 2018 të kërkojmë mbështetjen buxhetore që të ndihmojmë ministrin. Gjatë rishikimit keni siguruar mjetet për veteranët e UÇK-së për këtë vit. Me vjen mirë. Mirëpo, e dimë se do të ballafaqoheni edhe me shumë sfida vitet që vijnë.

Është përmendur se do të këtë rritje të pagave për sektorin publik. A përcillet kjo edhe me rritjen e pensioneve ? Nuk mundet që të rriten pagat në sektorin publik dhe nuk rriten pensionet, pra kjo është një çështje e pandashme.

Siguria dhe shëndeti në punë. Përveç se kemi një punësim shumë të ulët edhe ata që punësohen nuk ju garantohet siguria në punë. Kontratat e punës pa afatizim, punëtor pa kontrata. Pra nuk kemi siguri as financiare e as siguri për shëndetin apo jetën e punëtorëve.

Çështja e pagesës për fëmijët deri në moshën 5 vjeçare, duhet adresuar në të ardhmen. Për personat me aftësi të kufizuar është punuar, mirëpo, duhet ende të punohet për këtë kategori prej shkollimit e deri te punësimi, përballen me shumë padrejtësi.

Për pushimin e lehonisë, një grua edhe pas një jave, nëse është e nevojshme mund të dal në punë, mirëpo, këtu duhet të diskutohet edhe mendohet mirë për çështjen e fëmijës, pra mirëqenien e tij dhe këtu duhet mendohet se gjashtëmujori i parë i pushimit të lehonisë, duhet të bëhet i detyrueshëm për nenën në zbatim të Ligjit për gjdhënie. Në gjashtë mujorin e dytë, duhet të shqyrtohet mundësia që obligimet ti bartë shteti. Pjesën e dytë të pushimit të mendohet për një pushim prindëror, pra të kenë mundësi të marrë njeri nga prindërit, pasi që në gjashtëmujorin e dytë fëmija është në gjendje tjetër edhe mund të ushqehet edhe me ushqime tjera.

Sa i përket pensioneve familjare, është mirë që më në fund do të fillojë të implementimi edhe i kësaj skeme. Edhe në marrëveshjet bilaterale duhet të punohet, në mënyrë që qytetarët tanë sa më shpejtë të fillojnë ti gëzojnë të drejtat e tyre.

**Time Kadrijaj:** Ministria e MPMS-së është e vërtetë se është e ndjeshme dhe çdoherë kemi theksuar se ky komision ka në monitorim dy dikastere më të veçanta të qeverisë si MSH edhe MPMS. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve edhe përkundër vullnetit të mirë për ti mbështetur këto dy dikastere, edhe dukë bërë ligje të mira edhe të zbatueshme, jemi ballafaquar me mungesë të buxhetit. Ju përgëzoj për këtë ritëm të punës, sidomos për çështjen e veteranëve të UÇK-së, sigurimi i buxhetit gjatë rishikimit të buxhetit dhe me në fund veteranët do të jenë në një vije të rregullt buxhetorë dhe s'do të kenë problem në të ardhmen. Po ashtu, ju përgëzojmë për formimin e Komisionit për Invalidët e Luftës për përcaktimin e shkallës së invaliditetit. Kërkojmë që ky komision të funksionalizohet sa më parë dhe invalidët të fillojnë t'i gëzojnë beneficinet e tyre, për atë çka kanë kontribuar.

A jeni të kënaqur me shumën e buxhetit që ju është ndarë për Ministrinë e MPMS, pra a keni arritur t'i buxhetoni objektivat tuaja? Sa ligje do ti përfshini në programin legjislativ për vitin 2018?

**Haxhi Avdyli:** Kosova nuk është shtet i zhvilluar dhe numri i familjeve si përfitues të skemave sociale është i madh dhe po rritet çdo ditë. Çka do të bëni ju si ministër i ri në riaftësimin e këtyre përfituesve të skemave sociale? Pra a do të punohet që njerëzit që dalin nga skemat sociale edhe veteranët që të kenë përparësi në punësim në dy sektorët dhe a ka ndonjë politikë favorizuese në këtë drejtim? Sa do të punoni në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat? A do të këtë rritje të përkrahjes së shoqatave të shumta që janë në Kosovë edhe të cilat merren me mbështetjen dhe mbrojtjen e grupeve vulnerable që janë në Kosovë, siç janë shoqata HANDIKOS, Autizem, DownSyndrom e shumë shoqata të tjera. Sa do të jetë përkrahja në të ardhmen? Po ashtu edhe një çështje tjetër shumë e ndjeshme është çështja e lypsarëve, a keni ndonjë plan që ta zvogëloni apo zhdukni këtë fenomen, pasi kjo çështje po ia jep një imazh të keq vendit.

**Flora Borvina:** Komisioni do jetë bashkëpunues për zgjidhjen e çështjeve problematike që mbulon kjo ministri. Programi juaj është shumë ambicioz dhe ka shumë sfida. Ju pyes për disa çështje me interes, po flitet për rritjen e pagave në sektorin publik, a do të këtë rritje të pensioneve dhe të skemave sociale? Çështje tjetër është kushtet e pensionimit, ne nuk e kemi fondin pensional që është grabitur nga Serbia, por ne kemi trashëguar listat e atyre që kanë punuar dhe kontribuar në kohët më të vështira për Kosovën, si arsimi, shëndetësia dhe sektorët tjerë. Tani këtyre personave që kanë kontribuar nuk po u njihet përvoja e punës e kësaj periudhe, kjo është e padrejtë. Edhe çështja e kategorizimit nuk është bërë në rregull sipas përgatitjes profesionale, specializim dhe gradat tjera shkencore nuk janë marr parasys.

Çështje tjetër është marrëveshja për pensionet me Zvicrën dhe me disa shtete tjera po zvarritet nga mandati në mandat, thuajse nuk ka zgjidhje, e e vërteta është se kjo çështje ka zgjidhje.

Edhe pse marrëveshja me ish- Jugosllavinë është shkëputur prapë se prapë Serbia dhe Maqedonia i gëzojnë ende beneficionet e asaj marrëveshje, kurse qytetarët e Kosovës nuk i gëzojnë për shkak të paafësisë së institucioneve të Kosovës për t'u marr me çështjen seriozisht. Në këtë drejtim të jemi më energjik dhe të arrijmë sukses.

Kam një ankesë nga shtëpitë mbrojtëse të dhunës, të cilat janë të pambrojtura dhe të pambështetura, dhe nuk po kanë mundësi t'u dalin në ndihmë grave të abuzuara dhe të trafikuar.

Çështje tjetër është çështja e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve në punë. Kjo mbrojtje është shumë e dobët dhe Inspektorati dhe Këshilli Ekonomiko- Social nuk e kanë kryer punën e vet. Çdo ditë shohim shkeljen e të drejtave të punëtorëve dhe punëtorët nuk kanë guxim të ankohen sepse kanë frikë se do të largohen nga puna.

Problem tjetër janë edhe kontratat e punës në sektorin privat. Shumë punëtorë punojnë pa kontrata, edhe kur i kanë kontratat ato nuk respektohen. Kjo çështje është kompetencë e Inspektoratit të Punës, i cili ndoshta për shkak të numrit të vogël të inspektorëve nuk po arrin ta bëjë mbikëqyrjen e shkeljes së të drejtave të punëtorëve.

Gjithashtu si shtet nuk po arrijmë t'i mbrojmë të drejtat e fëmijëve, nuk kemi shtesa për fëmijë, edhe pse në Kosovë ka rënie rapide të natalitetit. Duhet të organizohet një tryezë ku do të diskutohet për mbrojtjen sociale të fëmijëve.

Kur flasim për papunësinë më intereson se të papunët të çfarë profileve janë?

Çështja e ish- të burgosurve, ju pyes se a do të rritet shuma për mbulimin e kompensimeve të parapara me ligj, për këtë kategori?

**Bekim Haxhiu:** Në mandatin e kaluar ishte ideja dhe propozimi që pako ligjore për kategoritë e luftës të plotësohet dhe të harmonizohet dhe të formohet një agjenci me sektorët e caktuar për të gjitha kategoritë. Edhe kategorizimi që është bërë me data, mendoj se është i përkohshëm dhe se

për të bërë kategorizimin e mirëfilltë, mund të merren modelet amerikane apo kroate. Këto duhet t'i keni si pjesë të strategjisë dhe punës suaj.

Ju njoftoj që në fund të mandatit të kaluar në Kuvendin e Kosovës me iniciativën time dhe të deputetes Xhevahire Izmaqi është realizuar një debat për të drejtat e punëtorëve. Nga debati kanë dalë disa rekomandime, të cilat nuk janë aprovuar por janë diskutuar në Kuvend. Shqetësuese ishin shkeljet kushtetuese që kanë ndodhur nga KEDS-i me largimin kolektiv nga puna të rreth 95 punëtorëve. Kërkoj angazhimin maksimal tuajin në ndërprerjen e shkeljeve kushtetuese, sepse largimet kolektive nga puna janë kundërkushtetues, janë të sanksionuara. Edhe Inspektorati i Punës ka marr një vendim lidhur me largimin e punëtorëve nga KEDS-it, por të cilin nuk e ka çuar deri në fund.

Shqetësues janë raportet që gjatë këtij viti, deri me tani 11 punëtorë kanë humbur jetën në vendin e punës dhe se kapacitetet e Inspektoratit të Punës janë të pamjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, ndërsa edhe raportet e inspektimit nuk i bëjnë publike.

Kërkoj që çdo raport i Inspektoratit të Punës të bëhet publik dhe të shihen edhe masat që janë marrë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Kemi rastin e humbjes së jetës së dy punëtorëve të Behtel & Enka dhe asnjë masë nuk është marr. Po të ndodhte kjo në ndonjë vend tjetër, kjo kompani ndoshta edhe do të mbyllej për shkak të rrezikimit të jetës së punëtorëve.

Kemi legjislacion që mbron të drejtat e punëtorëve, por shkeljet e të drejtave të punëtorëve po vazhdojnë, prandaj kërkoj një angazhim më të madh tuajin ministër në fuqizimin e Inspektoratit të Punës.

Ligji për paraplegjikët dhe tetraplegjikët është miratuar nga Kuvendi dhe e ka deklaraten financiare dhe duhet të zbatohet.

Sa i përket ndryshimit të Ligjit të Punës, te dispozitat për pushimin e lehonisë, duhet të kemi kujdes që me këtë ligj t'u krijojmë lehtësi lehonave dhe të jemi në shërbim të rritjes së popullsisë, sepse edhe në Kosovë nataliteti është në rënie.

**Besa Baftiu:** Siç po shihet nga diskutimet, problemet janë të mëdha dhe u dhanë edhe disa sugjerime, dhe u parashtruan edhe pyetje. Besoj se do të bashkëpunojmë që këto çështje të gjejnë zgjidhje.

**Skender Reçica:** Do të bëj përpjekje që në të gjitha pyetjet që u ngritën të jap përgjigje. Më vjen mirë që të gjitha çështjet që u ngritën, janë në harmoni me sfidat që kemi identifikuar si ministri, dhe me objektivat në kuadër të programit tonë qeverisës. Jam i hapur që bashkërisht me komisionin të bashkëbisedojmë për problemet që ekzistojnë.

Po filloj nga Ligji i Punës, që do të jetë një ligj i ri, që do të rregullojë shumë çështje që u ngritën, si problemi i kontratave, çështja e pushimit të lehonisë dhe të gjitha që u diskutuan këtu. Sa i përket marrëveshjeve bilaterale, marrëveshja me Zvicrën është pothuajse e përfunduar dhe ka mbetur vetëm të dakordohemi për datën e nënshkrimit të marrëveshjes. Me Belgjikën jemi në negociatë për arritjen e marrëveshjes. Me Austrinë kemi rifilluar negociatat dhe kemi përparime në atë drejtim. E kemi në plan fillimin e negociatave edhe me Sllovenin dhe Kroacinë.

Te Inspektorati i Punës dhe humbja e jetëve në vendin e punës, është shumë e dhimbshme dhe nuk ndjehemi mirë që kemi humbje të jetëve në vendin e punës. Si ministri do të angazhohemi maksimalisht që siguria në punë të jetë në nivelin që duhet të jetë. Do të punojmë në fuqizimin e Inspektoratit të Punës, si në shtimin e numrit të inspektorëve, në fuqizimin e tyre por edhe në kontrollin në punën e inspektorëve. Ftoj të gjithë ata që preken nga puna e inspektorëve që të bashkëpunojnë me ministrinë dhe të raportojnë të gjithë inspektorët që nuk kanë kryer punën si duhet.

Kemi parapa në strategjinë legjislative ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e punës dhe transpozimin e direktivave të BE-së në këtë ligj, me qëllim të fuqizimit të inspektoratit dhe rritjes

së sigurisë së punëtorëve në punë. Do të angazhohemi maksimalisht në respektimin e kontratave të punës dhe kam kërkuar bashkëpunim edhe me kolegët e dikastereve tjera qeveritare.

Sa i përket Komisionit Vlerësues për invalidët e luftës, jemi në zhvillimin e procedurave për hapjen e konkursit dhe besoj shumë shpejt do të funksionalizohet ky komision dhe invalidët e luftës mund t'i nënshtrohen komisionit mjekësor.

Te kategorizimi i veteranëve kemi një rregullore, e cila është përfunduar dhe pritet të dërgohet në Qeveri për miratim.

U fol për decentralizimin e kompetencave për çështjet sociale, mendoj se ka shumë punë dhe roli i komunave në çështjet sociale duhet të rritet, me kompetenca shtesë.

Te politikat e punësimit, një nga objektivat tona është t'i identifikojmë nevojat reale të tregut të punës, sepse duke u mbështet në disa hulumtime, kemi pa se ka shpërputhje në mes nevojave të tregut të punës dhe atyre se çfarë kuadros ofrojnë universitetet tona. I kam kërkuar bashkëpunim edhe ministrit të arsimit dhe donatorëve tjerë, që të rrisim kutikulat në qendrat e aftësisimit profesional.

Sa i përket njohjes së stazhit të punës, Ligji i Punës do ta rregullojë këtë çështje.

Sa i përket buxhetit, ju njoftoj se kemi 4 skema sociale për të cilat janë miratuar ligjet, si pensionet familjare dhe invalide , pastaj Ligji për paraplegjik dhe tetraplegjik, të cilat fare nuk kanë nisur të zbatohen sepse e nuk ka pasur buxhet për vitin 2017. Tani me rishikim, kemi marrë një zotim se do të fillojmë t'i zbatojmë këtë vit, ndërsa në vitin 2018, të gjitha skemat sociale dhe pensionet do të jenë të mbuluara me buxhet.

Sa i përket mbulimit të gjitha nevojave të Ministrisë së Punës, sigurisht që buxheti nuk është i mjaftueshëm, sidomos nuk jam i kënaqur me buxhetin e paraparë për masat aktive të punës. Me këtë synojmë që disa kategori të përfshira në kategorinë e dytë të skemat sociale të punësojmë në kompani publike përmes masave aktive të punësimit.

Te rritja e pagave dhe e pensioneve, disa nga skemat bazën e kanë të paga minimale dhe besoj që në mbledhjen e radhës së KES-it, do ta rrisim pagën minimale që do reflektojë edhe te disa kategori.

Çështjen e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve dhe çështjen e inspektoratit shumë shpejt do ta adresojmë.

Çështja e lypsarëve në rrugë është çështje e komunave dhe e MPB-së, por obligimet tona si ministri do të përmbushim.

Për të burgosurit politikë, ministria jonë e bën vetëm ekzekutimin e mjeteve sipas listave që vinë nga komisioni përkatës.

Sa i përket bashkëpunimit me shoqatat, kemi një bashkëpunim të mirë, dhe në kuadër të mundësive buxhetore dhe infrastrukturës ligjore, do t'i përkrahim sipas projekteve që ato i paraqesin.

Këto janë disa nga shqetësimet që u ngritën, por jam i hapur për bashkëpunim në të gjitha çështjet që ka nevojë të bashkëpunojmë.

**Flora Brovina:** A është ndarë buxhet për vitin 2018, për zbatimin e Ligjit për Viktimat e Dhunës Seksuale gjatë luftës?

**Skender Reçica:** Sa i përket Ligjit për Viktimat e Dhunës Seksuale gjatë luftës , gjatë vitit 2018 si ky ligj ashtu edhe të gjitha skemat tjera janë të mbuluara me buxhet. Besojmë se shumë shpejt komisioni vlerësues do të fillojë pranimin e aplikacioneve për këtë kategori.

**Bekim Haxhiu:** Thatë se për kategorizimin e veteranëve është punuar rregullorja, por është diskutuar edhe në Kuvend që Komisioni përveç kategorizimit ta bëjë edhe verifikimin . A



mendoni që ky komision që e ka mandatin ta bëjë kategorizimin, ta bëjë edhe verifikimin sepse ka shqetësime se numri i veteranëve nuk është i saktë.

**Skender Reçica:** Mendoj se kjo çështje është kompetencë e Komisionit qeveritar për verifikimin e kësaj kategorie.

**Enver Hoti:** Mendoj se kryetari i Komisionit qeveritar z. Çeku duhet të bëjë edhe një herë thirrje publike që të gjithë ata të cilët nuk janë veteranë të vërtetë të tërhiqen nga listat.

Ministër, na lejo të ndihmojmë në punën tuaj, e për të na lënë t'ju ndihmojmë duhet që ju të punoni mirë, qoftë në politikën e punësimit, në programimin e skemave pensionale e edhe në ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Punës.

**Bekim Haxhiu:** Sipas ligjit është themeluar komisioni qeveritar të cilin e ka udhëhequr z. Çeku dhe është arritur një konsensus sa i përket kësaj çështje, por se kush e ka shtuar numrin e veteranëve përgjegjësia bie te komandat lokale, e jo te kryetari i komisionit sepse ai nuk mund ta dijë se kush janë veteranët e vërtetë, e kush jo. Me ligjin e ri kemi krijuar edhe një komision të veçantë, i cili do të bëjë kategorizimet, ndërsa për ta bërë edhe një herë verifikimin, kjo çështje nuk ka kaluar në Kuvend. A ka gatishmëri që ministria të fillojë verifikimin edhe një herë, qoftë përmes ligjit të ri apo do të vazhdohet ta marrin të gjithë, si ata që janë veteranë si ata që nuk janë. Nëse presim që verifikimi të bëhet nga prokuroria, kjo mund të zgjas me vite.

**Skender Reçica:** Ne kemi listën e veteranëve që ka ardhur nga Komisioni qeveritar, dhe nëse me ligj parashihet që Ministria e Punës obligohet të marrë ndonjë aktivitet, ne do ta marrim pa hezitim. Mendoj se kjo është ende çështje në kompetencë të komisionit qeveritar.

**Besa Baftiu:** Siç tha edhe z. Hoti, të gjithë jemi të interesuar që Inspektorati i Punës të fuqizohet. Fare nuk më është dukur në rregull deklarata e kryeinspektorit, i cili deklaroi në rastin e fundit të vdekjes aksidentale në kompaninë Behtel & Enka, se vdekja në vendin e punës ka ardhur si shkak i pakujdesisë së punëtorëve, por edhe për shkak të mosplotësimit të kushteve të sigurisë në punë. Kjo nuk është deklaratë që ndihmon në zgjidhjen e problemeve, por favorizon kompanitë që po i shkelin të drejtat e punëtorëve. Po theksoj se punëtorët në kompanitë private janë shumë keq...

#### **Të ndryshme**

Për këtë pikë, nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

*E përgatiti:*

**Stafi m mbështetës i Komisionit**

**Kryetarja e komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**